



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL GJILAN
DREJTORIA E FINANCEVE ,EKONOMI & ZHVILLIM



RAPORT JANAR-QERSHOR /2010

Për :Kryetarin e Komunës Z.Qemajl Mustafa
Nga:Drejtori i Drejtorisë për Fianaca,Ekonomi &Zhvillim
Lënda: Raport pune për periudhën Janar-Qershor /2010

Gjatë kësaj periudhe Janar-Qershor të këtijë viti kalendarik në drejtorin e F.E.Zh.ka paturë aktivitet të ngjeshur lidhur me përgaditjen e fillimit të vitit buxhetor **2010**. Në fillim kemi bërë analiza të mirëfillta lidhur me kapacitete mbi stafin e këtijë drejtorati njashtu dhe ate material për qështjen e angazhimit të zyrtarëve të kësaj drejtorie. Ne si drejtori me stafin ekzistues i cili numron **38**,në sektorin e tatimit në prone **10** zyrtar ,në sektorin e buxhetit **16** zyrtar,në sektorin e thesarit **3** zyrtarë ,në sektorin për rexhistrimin e biznesit dhe dhënjen e lejes së punës **3** zyrtar,si dhe **zyrtarin** në inkubatorin e biznesit ,njëherit në këtë drejtori punon edhe zyrtari kryesor financiar. Ne kemi bërë vlerësimin e kapaciteteve financiare lidhur me tatimin në pronë dhe taksën për biznes.

Në Janar është bërë identifikimi i problemeve me të cilat ballafaqohen zyrtarë në teren si dhe janë marrë masa lidhur me këto probleme si dhe formatë e kontakteve me qytetarë.

-Në shkurtë jemi angazhuar edhe për përgaditjen e rregullorës për taksë komunale si dhe propozimin e komisionit për paraqitjen e plotësim ndryshimin e kësaj rregullore.

-Muajët Janar-Shkurt -Mars sa i përketë të hyrave vetanake nga tatimi në pronë, në këta muaj inkasimi nuk ka qenë në nivelin e knaqshëm ,sepse në bazë të planifikimit I cili ka qenë **212.499.00** ndërsa janë inkasuar **168.541.84 dmth 80%**.

-Ndërsa në muaji Prill-Maj-Qershor kemi një inkasim të lartë ,dhe ate planifikimi ka qenë **212.499.90** kurse realizimi është **262.454.31 apo 23%** tejkalim nga planifikimi. Prandaj marrë në tërsi realizimi I inkasimit të të hyrave nga tatimi në prone është **430.996.15** apo është realizuar **101.41%** ,dmth kemi tejkalim të realizimit për **1.41%**

-Sa i përketë të të hyrave nga taksat komunale për biznes sipas planifikimit për gjashtëmujor ka qenë planifikimi **127.500.00** ndërsa realizimi është **89.077.27 në % ,70%** .Lejet e punës të planifikuara **13.000.00** janë inkasuar **3.137.30** apo **24.13 %**.

-Sa i përket raportet e punës zyrtarët e këtijë drejtorati këto raporte janë: raporte javore, dhe mujore,-Kurse takime me zyrtarë kanë në qdo muaj ,por me shefat e sektoreve kanë takime javore.

-Sektori i buxhetit:

Në këtë sektorë janë lëshuar **11853** vërtetime të ndryshme siq janë:

- a) vërtetime për rexhistrimin e automjeteve,
- b)-II-II-II për nevoja përsonale.
- c)Vërtetime për ndihma sociale.
- d)Vërtetime për pagesë të taksës për biznes.
- e)Leje pune për subjekte afariste.

f) Certifikata për kryerjen e praktikës së studentëve dhe nxënësve në DFEZh.

- Ndërsa nga analistët e biznesit janë hartuar për taksë komunale: **2141** proqesverbale
- Janë shpërnda **434** vendime ,
- Në teren janë hasur të pa rexhistruara **185** subjekte afariste.
- Numri i vogël vendimeve për taksë , është pasojë e vonësës së ndryshimit të rregullorës për taksë dhe tarifa komunale.
- Në zyrën e thesarit janë bërë zotim për **1885** lëndë si dhe këto pastaj janë shpenzuar dhe qertifikuar nga zyrtarët e këtijë sektori.
- Sektori i tatimit në pronë ka zhvilluar këto aktivitete:
 - Janë faturuar **26730** objekte banimi si dhe objekte të tjera përcjellëse.
 - Ndërsa shuma totale e faturuar për tatim në prone për vitin buxhetor **2010** është **925.755.00€**.
- Rexhistrime të reja të objekteve janë 313 objekte.
- ndërsa objekte në ndërtim janë identifikuar 59.

Njashtu kem patur takime të rregullta me OSBE-n dhe me KFOR-in si dhe takime me drejtorët e financave të komunave të tjera, si Artanës ,Parteshit lidhur me qështjen e decentralizimit, si për qështjen e buxheteve .